

IN MEMORIAM

Carlo De Simone (1932–2023), albanologjia dhe Shqipëria

Më 14 shtator 2023 ndërroi jetë në Romë, qyteti i tij i lindjes (1932) profesori i gjuhësisë së krahasuar Carlo De Simone. Pas mbarimit të maturës më 1950 ai studioi gjuhësi të krahasuar dhe arkeologji klasike në Universitetin “La Sapienza” të Romës, ku u diplomua më 1955 me një tezë mbi mbishkrimet mesape: *Le iscrizioni messapiche: cronologia e fonetismo*. Më pas fitoi një bursë nga DAAD për të studiuar gjuhësi të krahasuar në Universitetin e Tübingenit në RFGJ në vitin akademik 1955–1956, pranë studiuesit të njohur të gjuhëve të lashta europiane, profesorit Hans Krahe e më pas u bë asistent i tij në vitet 1961-1964. De Simone u habilitua për të dhënë mësim në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Tübingenit me një punim mbi huazimet e greqishtes në gjuhën etruske.

Në vitet 1972-1973 De Simone drejtoi katedrën e gjuhësisë së krahasuar (indoeuropiane) në Universitetin e Vjenës, në vitet 1975-1980 punoi si profesor i glotologjisë në Universitetin e Peruxhës në Itali. Më 1980 emërohet përfundimisht si profesor i gjuhësisë së krahasuar në Universitetin e Tübingenit, duke trashëguar katedrën e njohur të themeluar nga mentori i tij Hans Krahe, ku punoi deri në daljen në pension më 1998.

Veprimtaria kërkimore-shkencore e De Simone-s u përqendrua kryesisht mbi gjuhët e lashta të Italisë, në radhë të parë tek mbishkrimet etruske dhe ato mesape, për të cilat ka botuar një numër të konsiderueshëm artikujsh dhe kumtesash. Hulumtimet mbi mesapishten e lidhën De Simone-n edhe me studimet ilire e me albanologjinë dhe me kolegët shqiptarë. Hulumtimit të mesapishtes De Simone do t'i kthehet herë pas here në veprimtarinë e tij, duke hedhur themelet e studimeve sistematike të kësaj gjuhe të dëshmuar në mënyrë të fragmentuar dhe duke e vendosur atë në kontekstin më të gjerë të lidhjeve gjuhësore e kulturore ndërmjet brigjeve të Adriatikut. Në këtë kuadër më 1964 në pjesën e dytë të vëllimit *Die Sprache der Illyrier* (Gjuha e ilirëve) u botua ndihmesa e De Simone-s me titullin “Die messapischen Inschriften” (Mbishkrimet mesape). Këtu për herë të parë jepet një paraqitje e përgjithshme e sistematizuar e tyre. Hyrja përmban një kronologji të alfabetit të mesapishtes, i cili është huazuar nga alfabeti i greqishtes i Tarantos. Mbi bazën e hulumtimeve të imëta De Simone dallon këtu katër faza të zhvillimit të alfabetit

dhe të mbishkrimeve mesape: 1. Fazën arkaike, e cila ndahet në tri periudha: periudha e hershme arkaike (fundi i shek. VI – fillimi i shek. V p.e.r.), periudha arkaike (490/480 – 444/433 p.e.r.) dhe periudha subarkaike (444/443 – 400 p.e.r.); 2. Fazën klasike, që ndahet në periudhën e parë (gjysma parë e shek. IV p.e.r.) dhe periudhën e dytë (gjysma e 2-të e shek. IV p.e.r.); 3. Fazën helenistë-romake, e cila po ashtu ndahet në dy periudha: periudha e parë (shek. III p.e.r.) dhe periudha e dytë (shek. III-II p.e.r.); 4. Fazën republikane (shek. II-I p.e.r.).

Ky punim themelor për studimet mesape shërbeu si bazë e *Monumenta Linguae Messapicae* (MLM) në dy vëllime (2002), vepër e cila është një botim analitik i të gjitha mbishkrimeve mesape të botuara deri atëherë. Vepra është hartuar nga bashkëpunëtorja e tij Simona Marchesini (vëll. I me korpusin epigrafik) dhe Carlo De Simone (vëll. II me *index verborum*, listën e lemave të izoluara të mesapishtes dhe një pasqyrë gramatikore). Vepra përbën njërin ndër tekstet themelore, mbi bazën e të cilit janë zhvilluar më tej studimet mesape, deri në sintezën më të fundit *Einführung ins Messapische* (2014) të indoeuropianistit dhe albanologut bashkëkohor austriak Joachim Matzinger (https://www.academia.edu/8686856/Einf%C3%BChrung_ins_Messapische), ku ndihmesat e Carlo De Simone-s zënë kryet e vendit në bibliografinë e cituar.

Thelbësore është ndihmesa e De Simone-s edhe në studimin e antroponimisë ilire, temë të cilën ai e ka trajtuar në disa konferenca dhe artikuj të ndryshëm, si: “Le iscrizioni della necropoli di Durazzo. Nuove osservazioni”, botuar së pari në revistën *Studia Albanica* 12/1975, 2, 95–116 dhe më pas në *Studi Etruschi* 45/1977, 209–235; “L’elemento non greco nelle iscrizioni di Durazzo ed Apollonia” (1993), në Cabanes, Pierre (bot.) *Grecs et Illyriens dans les inscriptions en langue grecque d’Épidamne-Dyrrhachion et d’Apollonia d’Illyrie. Actes de la Table ronde internationale (Clermont-Ferrand, 19–21 octobre 1989, Paris, 35–75* dhe “Ancora sull’ ‘illirico’ Genti” (1999) në Cabanes, Pierre (bot.), *L’Illyrie méridionale et l’Épire dans l’antiquité. 3. Actes du III^e colloque international de Chantilly (16–19 octobre 1996)*, 71–72. Në veçanti në ndihmesën e vitit 1993 De Simone ka pasuruar inventarin e emrave ilirë të formuluar së pari nga Radoslav Katičić 1962 me emra të rinj dhe forma të tjera rasore të emrave ekzistues, duke mundësuar përmes tyre hulumtimin e aspekteve të veçanta morfologjike dhe fonetike të ilirishtes. Gjithashtu De Simone ka nxjerrë në pah edhe përkime ndërmjet antroponimisë mesape dhe asaj jogreke të Dyrrachiumit të lashtë, duke vënë në dukje faktin se komunikimi ndërmjet dy brigjeve të Adriatikut në lashtësi ishte krejt i natyrshëm.

Kam pasur fatin dhe mundësinë që me përkujdesjen e veçantë të profesorit Carlo De Simone të studioj në Seminarin për Gjuhësi të Krahësuar (*Seminar für Vergleichende Sprachwissenschaft*) të Universitetit të Tübingenit në vitin akademik 1993-1994 e më pas të mbroj atje doktoratën në gjuhësi të krahësuar nën drejtimin e tij si *Doktorvater* (udhëheqës shkencor) i parë dhe të

profesorit Wilfried Fiedler, në atë kohë drejtues i katedrës së albanologjisë në Universitetin e Mynihut, si *Doktorvater* i dytë. Në leksionet dhe seminarët e tij si edhe në veprimtarinë hulumtuuese-studimore në lëmin e gjuhësisë historike Carlo De Simone udhëhoqë gjithmonë nga rigoroziteti metodik, besnikëria ndaj së vërtetës shkencore të dokumentuar e të zhveshur nga mitet historike-gjuhësore mbi prejardhjen e popujve dhe të gjuhëve, produkte të nacionalizmit të helmët të shfaqur në Europë ndërmjet shekujve XIX-XX, shkaktar i tragjedive të tmerrshme në gjysmën e parë të shekullit XX, i cili vijoi të gjëllinte më tej në Europën Lindore e veçanërisht në Ballkan edhe pas rënies së Murit të Berlinit, duke shkaktuar edhe këtu tragjedi të tjera të rënda, plagët e të cilave nuk janë mbyllur ende. Në leksionet e veta ai përmendte shpesh shembullin e mentorit të vet Hans Krahe, i cili në fillim e shihte ndikimin e ilirishtes të shtrirë në pjesën më të madhe të Europës kontinentale (teori e cila u quajt në mënyrë kritike *panilirizëm* nga bashkohësit), por së fundi, mbi bazën e të dhënave dhe hulumtimeve të reja, pranoi se një vizion i tillë nuk ishte i saktë. Për Carlo De Simone-n ky ishte një shembull i lartë i ndershmërisë intelektuale, e cila duhet të karakterizojë çdo studiues dhe çdo tezë shkencore që duhet të ngrihet mbi bazën e “vërtetimit të plotë, të provueshëm me terma rreptësisht të përpikta”, siç shprehet në artikullin “Gjendja e sotme e studimeve ilire dhe problemi i gjuhës mesape”, të botuar në revistën *Studime filologjike* (1973, nr. 3), në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet ilirishtes dhe mesapishtes, ku De Simone arrin në përfundimin se “mbi bazën e njohjes së sotme të mesapishtes jemi të detyruar që mesapishten për tani ta konsiderojmë si gjuhë më vete, të lokalizuar në Itali, karakteristikat e së cilës duhet të jenë ende objekt studimi”.

Carlo De Simone e kishte vizituar Shqipërinë në vitet '80 të shekullit të kaluar, ndër të tjera edhe për të hulumtuar mbishkrimet në Gjirin e Gramës në Karaburun. Ai ka hulumtuar edhe mbishkrimet e lashta në Grotta della Poesia, në Torre dell'Orso, përballë Karaburunit dhe hamendësonte se mbishkrimet në të dyja këto pika duhet të kishin shumë gjëra të përbashkëta falë vendndodhjes së tyre gjeografike. Fatkeqësisht ky projekt nuk mundi të realizohej, sepse atëherë Karaburuni, së bashku me Sazanin, ishte zonë ushtarake e mbikëqyrur rreptësisht, ku nuk mund të afrohej askush.

Carlo De Simone e kaloi fëmijërinë dhe rininë e hershme në Romën e periudhës së trazuar të Luftës së Dytë Botërore, duke u përballur me vështirësitë dhe privimet e kohës dhe duke përjetuar personalisht mizoritë e luftës dhe egërsinë e fashizmit. Kjo ndikoi në krijimin e botëkuptimit të tij si intelektual i angazhuar në jetën përditshme, e kundërta e figurës së eruditit të mbyllur në kullën e fildishit. Ai ishte një antifashist dhe antimilitarist i bindur, që në atë periudhë paqësore të jetës së Europës nuk ngurronte kurrë t'u përcillte studentëve dhe kolegëve më të rinj përvojën e tij të jetës dhe t'i paralajmëronte për rrezikun që sjell përgjumja dhe harresa e historisë. Vlerësonte shumë

“Gjeneralin e ushtrisë së vdekur” të Kadaresë, ku më mirë se shumëkund lexuesi përjeton kotësinë e luftës, monotoninë dhe zbrazëtinë shpirtërore që ajo lë pas.

Edhe pse relativisht modeste, ndihmesa e Carlo De Simone-s në lëmin e albanologjisë bart vlera të veçanta dhe origjinale, të cilat e pasurojnë traditën e saj të vyer. Ai mbeti deri në fund një mik i mirë i Shqipërisë dhe i shqiptarëve. Interesohej gjithmonë për miqtë dhe kolegët në Shqipëri dhe për zhvillimet e përgjithshme, si edhe për ato të fushave të veçanta që lidheshin me interesat e tij shkencore. Carlo De Simone ka lënë mbresa të pashlyeshme tek të gjithë kolegët shqiptarë që e kanë njohur, të cilët e kanë ruajtur dhe e kanë përcjellë kujtimin e tij si një dijetar i pasionuar dhe si një mik i dashur e i sinqertë.

Genc Lafe